



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:080259

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663543

PKR.nr.273/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetaren e trupit gjykues - gjyqtaren gjykuese Fatime Dërmaku dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët Naser Foniqi dhe Ertan Sejfulla, me zyrtares ligjore Tringë Zogaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.K për veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (“KPRK”), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.891/2014, të datës 04.05.2016, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me datë 28.03.2024, në prani të Prokurores së Shtetit Dulina Hamiti dhe të akuzuarit A.K me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. V.K me datë 29.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29 prill 2024, me shkrim e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.K nga i ati ... dhe e ëma ... e gjinisë ... i lindur me datë ... në ... ku edhe jeton, në fshatin ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse,

Më datë 18.07.2014, rreth orës 20:40, në Qikatovë të Re, Komuna e Drenasit, prapa shtëpisë së shëndetit, me qëllim që vetës të i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës

e ka grabitur të dëmtuarën L.Z në atë mënyrë që derisa e dëmtuara L.Z ishte duke ecur në këmbë i pandehuri A.K i ka shkuar nga prapa, për një çast e sulmon të dëmtuarën duke ia mbyllur gojën me duar, e ka goditur me grusht në nofull dhe ka arritur të ia marr çantën e krahut në të cilën e dëmtuara kishte pasur 150, 00 (Një qind e pesëdhjetë) Euro dhe me të shpejtë ka ikur me vrap në drejtim të rrugës kryesore.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së.

-Pala e dëmtuar, L.Z për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë buxhetore të Gjykatës.

## A R S Y E T I M I

### 1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 04.05.2016, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.891/2014, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.K për shkak të veprës penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar, të mbajtur me datë 23.01.2019, i akuzuari është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar, andaj edhe është udhëzuar për të drejtën e tij për parashtrim të kundërshtimit të provave dhe paraqitjes së kërkesës për hedhje të aktakuzës. I akuzuari përmes avokatit mbrojtës, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimet e provave, mirëpo Gjykata me aktvendimin PKR.nr.273/2016, të datës 22.06.2020, e ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit, për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimet e provave.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datë 25.03.2024 dhe datë 28.03.2024, ku të pranishëm kanë qenë: prokurorja e shtetit Dulina Hamiti dhe të akuzuarit A.K me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. V.K .

Pas administrimit të provave, prokurorja e shtetit Dulina Hamiti në fjalë përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari A.K e ka kryer veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së, e cila është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarës L.Z e dhënë në polici, e që është administruar si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku e njëjta gjatë deklaratës së dhënë në polici e ka identifikuar të pandehurin A.K se i njëjti e ka kryer veprën penale të grabitjes ndaj të dëmtuarës, ku i pandehuri me përdorim të forcës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarën L.Z duke e goditur me grusht në nofull dhe ka arritur t'ia marrë çantën e krahut të njëjtës në të cilën i ka pasur 150 euro. Kjo vërtetohet edhe nga raporti i zyrtarit policor Enver Kastrati, i datës 13.08.2014, i cili në atë raport ka cekur në tërësi se si e dëmtuara L.Z e ka identifikuar të pandehurin A.K të cilat ia ka prezantuar zyrtari policor në polici. Pra, e dëmtuara L.Z e ka identifikuar të pandehurin A.K që ky është kryesi i veprës penale, që ia ka marrë çantën në të cilën i ka pasur 150 euro, duke ia mbyllur gojën dhe duke e goditur në nofull, krejt kjo me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës dhe atë në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv.

Tutje ka shtuar se kjo gjendje e fakteve vërtetohet edhe nga foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës, ku atë që e ka cekur zyrtari policor në raportin e tij ku e dëmtuara L.Z e ka bërë identifikimin e të pandehurit A.K si kryes i kësaj vepre penale, ku e njëjta në tërësi e ka përshkruar të njëjtin në deklaratën e dhënë në polici kur e ka bërë identifikimin e të pandehurit. Andaj, ka shtuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin A.K ta shpall fajtor për veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së dhe me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit të merren parasysh rrethanat rënduese si: mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale, rrethanat në të cilat i pandehuri e ka kryer veprën penale, peshën e rëndë të kësaj vepre penale dhe pasojën e shkaktuar tek e dëmtuara me kryerjen e kësaj vepre penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K av. V.B, në fjalë përfundimtare ka deklaruar se pas analizimit, trajtimit dhe administrimit të provave dhe fakteve që ishin objekt i shqyrtimit përgjatë kësaj çështje gjyqësore është vërtetuar mungesa e veprimeve inkriminuese nga ana e të akuzuarit, ku përmes provave të cilat i janë bashkangjitur këtij procesi, është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se akuza që rëndon mbi të akuzuarin nuk gjen asnjë mbështetje në legjislacionin penal që i njëjti të akuzohet për një vepër për të cilën sipas provave të cilat janë shqyrtuar në këtë çështje as minimalisht nuk e kanë inkriminuar, e as që ka të bëjë fare me rastin,

e që konstatohet përmes raportit zyrtar policor të datës 20.07.2014, në të cilën e dëmtuara në këtë raport, ka theksuar se pasi e sheh A.K n, ka deklaruar se ky person nuk është personi i cili dyshohet se ia ka marrë çantën në ditën kritike, ndërsa provat e tjera siç është deklarata e të dëmtuarës, e njëjta as minimalisht nuk plotëson standardin e kërkuar ligjor që e njëjta të trajtohet si provë, për arsye se gjatë gjithë deklaramit të saj e njëjta është e paqartë, kontradiktore dhe thjeshtë nuk mund të ndriçohet asnjë fakt i rëndësishëm për këtë proces nga dëshmia e saj, ndërsa sa i përket provave të tjera, tek çështja e ballafaqimit fizik është konstatuar se të njëjtat nuk janë në harmoni me legjislacionin penal, e që rrjedhimisht prova të tilla nuk mund dhe nuk duhet të pranohen nga ana e gjykatës. Në fund ka shtuar se i akuzuari nuk ka të bëjë me këtë vepër penale, i njëjti siç edhe ka deklaruar në ditën kur ka ndodhur rasti kishte qenë në qytetin e Prishtinës dhe lidhur me rastin e ndodhur e ka kuptuar vetëm pasi që është kontaktuar nga ana e organeve të rendit e që në mënyrë vullnetare është paraqitur dhe ka dëshmuar lidhur me veprimet e tij një ditë para. Gjykatës i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të sjell vendim lirues, sepse përmes kësaj aktakuze nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale.

I akuzuari A.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

## 2.Konstatimet e Gjykatës

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, gjykata, konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se më datë 18.07.2014, rreth orës 20:40, në Qikatovë të Re, Komuna e Drenasit, prapa shtëpisë së shëndetit, me qëllim që vetës të i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës e ka grabitur të dëmtuarën L.Z në atë mënyrë që derisa e dëmtuara L.Z ishte duke ecur në këmbë i pandehuri A.K i ka shkuar nga prapa, për një çast e sulmon të dëmtuarën duke ia mbyllur gojën me duar, e ka goditur me grusht në nofull dhe ka arritur të ia marr qantën e krahut në të cilën e dëmtuara kishte pasur 150, 00 (Një qind e pesëdhjetë) Euro dhe me të shpejtë ka ikur me vrap në drejtim të rrugës kryesore.

### 3.Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave:

#### 3.1. Provat personale:

Deklaratat e të dëmtuarës - dëshmitares L.Z të dhënë në polici, më datë 18.07.2014 dhe më datë 12.08.2014.

#### 3.2. Provat materiale:

- Raporti i zyrtarit policor Enver Kastrati i datës 13.08.2014,
- Raporti i zyrtarit policor Mehmet Cakiqi i datës 20.07.2014,
- Foto-dokumentacioni nga shkresat e lëndës.

#### 3.3. Deklarimi i dëshmitares

E dëmtuara - dëshmitarja L.Z në deklaratën e dhënë në polici më datë 18.07.2014, kishte deklaruar se rasti kishte ndodhur rreth orës 20:40, deri sa kishte qenë duke u kthyer nga puna, nga butiku i saj, në Drenas, në një rrugë e këmbësorëve që lidhet me rrugën Adem Jashari dhe shtëpisë së shëndetit dhe aty personi i dyshuar i kishte marr nga dora një çantë të vogël të dorës, me ngjyrë të zezë ku e mbante pazarin ditor, shumën prej 150, 00 euro. Kishte shtuar se gjatë kohës sa ia kishte marr çantën e kishte goditur në faqen e majtë dhe në buzë, me boks, më pas kishte bërë titur dhe kishte shkuar me atë personin (fy taz), pastaj kishin ardhur disa qytetar për ndihmë, por ai me shpejtësi kishte ikur nëpër një livadh, kishte shkuar në drejtim të rrugës kryesore, ka punëtori që rregullon agregata (gjeneratora). Në fund ka shtuar se për të dëshmuar është Gani Leku, kur dhe kishte qenë duke i kërkuar syzet.

3.2. E dëmtuara - dëshmitarja L.Z në deklaratën e dhënë në polici më datë 12.08.2014, kishte deklaruar se më datë 18.07.2014, rreth orës 20:40, deri sa ishte duke shkuar në shtëpinë e saj në Qikatovë të Re, Komuna e Drenasit, në rrugën e këmbësorëve e cila kalon afër shtëpisë së shëndetit dhe del në rrugën e Jasharajve, para se të dalë në rrugën e asfaltuar tek një muri, aty afër një shtyllë elektrike, një person që kishte qenë duke ecur pranë saj, ia kishte mbyllur gojën dhe ia kishte kapur çantën e kishte në dorë, pastaj me dorën që ia kishte mbyllur gojën ia kishte

gjuajtur syzet në tokë, pastaj pasi kishte filluar të bërtas, e kishte lëshuar, por që kishte arritur të ia marr çantën, duke e goditur me boks në fytyrë, në nofull dhe pastaj kishte ikur në drejtim të rrugës kryesore Drenas – Skenderaj. Ka shtuar se i njëjti kishte qenë i moshës së re në mes të moshës 18-20 vjeçare, kishte qenë shumë më i gjatë se sa e dëmtuara, pak zeshkan, me flokë të vogla, ngjyrë të zezë, i veshur në pjesën e sipërme me maicë ngjyrë të kaltër të mbylltë. Tutje ka deklaruar se nga disa fotot që i kishte parë në polici, të disa personave, personi me emrin A.K është personi që më së shumti ka dyshuar, sepse më së shumti i përshtatet personit që e kishte goditur dhe e kishte grabitur çantën. Tutje kishte shtuar se këtë person e kishte parë edhe disa herë të tjera, në vendin ku kishte ndodhur rasti, ku edhe një herë e kishte shikuar dhe aty kishte vërejtur se ishte shqetësuar i njëjti. Kishte theksuar se për të njëjtin e di se punon në Qikatovë të re, në firmën e ndërtimtarisë “Vëllezërit Asllani” dhe çdo herë pasi e kishte përfunduar punën e kishte takuar personin që e ka grabitur dhe punëtorët tjerë të asaj firme, prandaj ka shtuar se dyshon se kishte qenë ai person që më së shumti i ka ngjarë personit që e ka grabitur, nga se i njëjti e ka ditur se ku punon, shtëpinë së ku jeton, orarin e punës, andaj edhe përmes fotove më së shumti i ka përngjarë, kjo duke u bazuar në madhësinë, dukjen, veshjen, fytyrën, shiqimin dhe ecjen e tij.

#### 4.Deklarimi i të akuzuarit

I akuzuari A.K në mbrojtjen e tij ka deklaruar se më datë 18.07.2014, më sa i kujtohet kishte qenë ditë normale, fundi i vitit të shkollës së mesme për përgatitje të provimit për testin e maturës. Ka shtuar se ditën kritike, pas mesditës (në ora 12:00), me taksi ishte nisur rrugës për te dajhtë dhe ishte ndalur te shoku i tij Lauranti, që në atë kohë kishte jetuar në Fushë Kosovë dhe nuk e ka përfshirë në këtë rast sepse nuk e ka parë të arsyeshme. Më Laurantin kishin shkuar në Prishtinë, pasi kishte qenë koha që kishte ushtruar basketboll, pastaj kishin dalë për të pirë kafe dhe për të shëtitur në Prishtinë dhe nga ora 22:00-23:00 kishte qenë në gjumë te dajhtë e tij. Ndërsa, të nesërmen e kishte thirrur prindi i tij duke i bërtitur, me të shara dhe aty e kishte kuptuar se duhet të lajmërohej në polici dhe në Drenas kishte qenë e pamundshme që të shkoj aq vonë dhe nuk kishte pasur veturë të tij, ndërsa të nesërmen kishte shkuar në Drenas, fillimisht në shtëpinë e tij e më pas ishte paraqitur në stacion policor në Drenas. Tutje ka shtuar se L.Z e kishte njohur, si dhe vëllain e saj e ka njohur dhe e kishte pasur shumë shokë, ku policisë i ka kërkuar që ta thërrasin të njëjtin, por që policia i kishte thënë se nuk duhet të ketë kontakt me të. Ka theksuar se me vëllain e L.Z raportet i ka të njëjta, si gjithmonë normale, sikurse para rastit. Më tej ka pohuar se L.Z e kishte takuar disa herë kur kanë shkuar në shkollë bashkë me vëllain e saj

E. që e ka shokë. Ka shtuar se pas ngjarjes, E. as edhe një shikim të keq nuk ia kishte dhënë sepse ka shtuar se e njej mirë. Ndërsa, me familjaret dhe të dëmtuarën pas rastit nuk është takuar më asnjëherë. Lidhur me gjendjen ekonomike ka theksuar se në atë kohë e ka pasur të mirë-të mesme, ku kishte punuar edhe në atë kohë me piktura dhe murale të ndryshme, ndërsa më pas kishte filluar që të punoj në call center ku edhe ende punon aty. Në fund ka shtuar se aktakuza e prokurorisë si e pa bazë i ka penguar shumë në jetë dhe i ka sjellur telashe.

#### 5.Elementet e veprave penale

Nga paragrafi 1 i nenit 329 të KPRK (Kodi Penal nr. 04/L-082 i Republikës së Kosovës), është paraparë forma themelore e veprës penale të Grabitjes, të cilën vepër sipas kësaj dispozite ligjore e kryen: “Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t’i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”.

Nga provat e administruara nuk u vërtetua fakti se, në veprimet e të akuzuarit A.K janë manifestuar elementet e kësaj veprë penale, për të cilën arsye Gjykata, të njëjtin e liroi nga akuza.

#### 6.Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në këtë çështje penale nuk ishte kontestuese fakti se të dëmtuarës L.Z i’ a kishin grabitur çantën e dorës, në të cilën kishte shumën prej një qind e pesëdhjetë euro, natën kritike. Nuk ishte kontestuese se tani i akuzuari dhe e dëmtuara përpara rastit ishin njohur si figura ndërmjet vete.

Kontestuese në këtë çështje penale ishte se a kishte qenë tani i akuzuari A.K ai që ka grabitur me përdorimin e forcës fizike, duke i’ a marr çantën dhe parat e të dëmtuarës natën kritike.

Gjykata, pas analizimit me shumë kujdes të të gjitha provave një nga një e në lidhshmëri me njëra tjetrën, të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se me asnjë provë personale dhe materiale, nuk është vërtetuar teza e akuzës, se i akuzuari A.K ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar. Gjykata vlerëson se të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, vërtetuan pa fajësinë e të pandehurit se nuk është kryes i veprës penale me të cilën është ngarkuar.

Për të ekzistuar vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri A.K me këtë vepër penale duhet të cenohen, sulmohen dy vlera, liria dhe pasuria, andaj për këtë arsye kjo vepër penale është vepër e përbërë, kjo pasi lidhur me këtë vepër penale duhet të ekzistoj dashja e kryerësit, ai duhet të jetë i vetëdijshëm se forcën apo kanosjen serioze e përdor për ta marrë sendin e huaj të luajtshëm me qëllim të përvetësimit, pra qëllimi i forcës dhe kanosjes serioze është për ta thyer dhe nënshtruar rezistencën e poseduesit të pasurisë së luajtshme.

Andaj, duke ju referuar kësaj pike, Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, absolutisht nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari A.K ka kryer veprën penale grabitja nga neni 329 par.1, përkatësisht sipas aktakuzës se më datë 18.07.2014, rreth orës 20:40, në Qikatovë të Re, Komuna e Drenasit, prapa shtëpisë së shëndetit, me qëllim që vetës të i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës e ka grabitur të dëmtuarën L.Z në atë mënyrë që derisa e dëmtuara L.Z ishte duke ecur në këmbë i pandehuri A.K i ka shkuar nga prapa, për një çast e sulmon të dëmtuarën duke ia mbyllur gojën me duar, e ka goditur me grusht në nofull dhe ka arritur të ia marr çantën e krahut në të cilën e dëmtuara kishte pasur 150, 00 (Një qind e pesëdhjetë) Euro dhe me të shpejtë ka ikur me vrap në drejtim të rrugës kryesore.

Në anën tjetër, nga provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, edhe atë nga deklaratat e dhëna në polici nga e dëmtuara L.Z të datës 18.07.2014 dhe datë 12.08.2014, ani pse e njëjta ka përshkruar në tërësi veprimet e kundërligjshme të personit që me forcë duke e goditur me boks në fytyrë, përkatësisht në nofullën e majtë, kishte arritur të ia marr çantën e saj, ku kishte shumë të hollave prej një qind e pesëdhjetë euro, e duke përshkruar vendin se ku ka ndodhur ngjarja dhe dukjen e personit që ka grabitur, të njëjtat deklarata Gjykata i ka vlerësuar në tërësi, por që nga këto prova nuk është arritur të identifikohet kryerësi i veprës penale për asnjë moment, andaj edhe këto prova personale në këtë çështje penale nuk e kanë inkriminuar tani të akuzuarin në asnjë formë.

Për më tepër, nga dy fotot që të dëmtuarës i ishin prezantuar në polici, të dy personave të dyshuar, përkatësisht të tani të akuzuarit A.K dhe një personi tjetër me emrin Sh.SH, e ku e dëmtuara kishte deklaruar se veprën penale ndaj saj e kishte kryer A.K Gjykata ka vlerësuar se mënyra që i është ofruar të dëmtuarës me vetëm dy foto për të identifikuar kryerësin e veprës penale, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenit 116 par.2,



ku për identifikim përveç të dyshuarit duhet të paraqiten edhe persona të tjerë, andaj edhe pretendimet e prokurorisë bien si të pa bazuara dhe në kundërshtim me nenin 116 të KPPRK-së.

Se tani i akuzuari A.K nuk kishte qenë ai që ka kryer grabitjen, Gjykata e ka marr për bazë Raportin e zyrtarit policor Mehmet Cakiqi të datës 20.07.2014, se pasi e kishte kontaktuar viktimën, e njëjta kishte ardhur në stacion për ta identifikuar të dyshuarin dhe pasi e kishte shikuar nga brenda të dyshuarin në oborr të stacionit kishte deklaruar se “Nuk është personi që ia kishte grabitur çantën”. Andaj, Gjykata konstaton se me këtë provë nuk është inkriminuar i akuzuari A.K pasi që vetë e dëmtuara pasi e kishte parë të njëjtin kishte deklaruar se nuk është personi që me forcë i’a kishte grabitur çantën natën kritike.

Po ashtu, nga Raporti i zyrtarit policor Enver Kastrati i datës 13.08.2014, me të cilin është përshkruar se lidhur me rastin Grabitja, e raportuar më datë 18.07.2014, kishte dhënë deklaratë ankuesja tani e dëmtuara L.Z duke përshkruar rastin se si kishte ndodhur. Pastaj lidhur me rastin kishin marrë në pyetje disa persona, si dhe personin e dyshuar A.K . Lidhur me këtë çështje penale, përsëri ishte ftuar e dëmtuara L.Z të cilës i ishin paraqitur fotot e personave të dyshuar për identifikim, ku e njëjta kishte theksuar se e ka grabitur personi A.K nga Qikatova e Re. Gjykata edhe me këtë provë nuk ka gjetur asnjë lidhshmëri në drejtim të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri A.K sepse i njëjti nuk është identifikuar nga e dëmtuara dhe nga raporti i datës 20.07.2014 i zyrtarit policor Mehmet Cakiqi, e dëmtuara pasi e kishte parë brenda policisë A.K n, kishte deklaruar se nuk ishte ai që e kishte grabitur. Ndërsa, më vonë, sipas fotove të paraqitura për identifikim kishte deklaruar se ishte A.K ai që e kishte grabitur, andaj Gjykata nuk e ka vlerësuar sepse e njëjta e kishte parë aty për aty të dyshuarin dhe kishte deklaruar se nuk kishte qenë ai, por edhe mënyra se si i janë prezantuar dy foto me dy të dyshuar për prezantim nga zyrtaret e policisë, janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenit 116 par.2, ku për identifikim përveç të dyshuarit duhet të paraqiten edhe persona të tjerë, andaj edhe nuk e ka marr për bazë dhe si të tilla nuk krijojnë lidhshmëri dhe as përgjegjësi penale për të pandehurin në raport me veprën penale grabitja.

Nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, i përbërë me dy foto të bëra nga zyrtaret policor, që mbajnë datën 2014/08/09, e që janë realizuar në stacion policor për identifikim të të pandehurit, ku shihet i pandehuri A.K duke mbajtur një letër me emër, mbiemër dhe datë të lindjes së tij, e të cilat foto janë irelevante, andaj edhe të njëjtat nuk i mori për bazë sepse nuk provojnë asgjë lidhur me këtë çështje penale.

Gjykata vlerëson se, nga deklaratat e dhëna nga e dëmtuara në polici më datë 18.07.2014 dhe më datë 12.08.2014, si dhe nga Raporti i zyrtarit policor Enver Kastrati i datës 13.08.2014, Raporti i zyrtarit policor Mehmet Cakiqi i datës 20.07.2014 dhe Foto-dokumentacioni nga shkresat e lëndës, nuk provojnë veprimet inkriminuese të të pandehurit në raport me veprën penale Grabitja, por përkundrazi ato vërtetojnë pafajësinë e tij në raport me këtë vepër penale.

Nga provat e administruara, Gjykata nuk ka gjetur përgjegjësinë penale të të pandehurit, në drejtim të veprës penale Grabitja, kështu në asnjë formë nuk u provua teza e akuzës së prokurorisë se i pandehuri A.K ishte ai që ka kryer veprën penale të grabitjes, sepse me asnjë provë të vetme personale dhe materiale, të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar se A.K ishte ai që natën kritike të datës 18.07.2014, rreth orës 20:40, në Qikatovë të Re, Komuna e Drenasit, prapa shtëpisë së shëndetit, ishte prezent, apo ishte konfrontuar me të dëmtuarën L.Z, duke i'a grabitur çantën me forcë, por as nga personat e tjerë nga të cilët L.Z ka thekuar se ka bërë titur duke i'u kërkuar ndihmë, nuk e kanë parë të njëjtin.

#### 7.Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe sipas nenit 363, paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, Gjykata e liroi nga akuza të akuzuarin A.K për veprën penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPPRK-së edhe atë duke u bazuar edhe në parimin indubio pro reo, nga neni 3 par 2 të KPP, e cila dispozitë në mënyrë eksplicite përcakton: “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen, ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Kjo për faktin se e dëmtuara, njëherë ka deklaruar se e ka identifikuar të pandehurin A.K mandej, herën tjetër, kur e ka parë realisht (live) ka deklaruar se nuk ishte ai, prandaj, në një situatë të tillë, kjo mëdyshje se ishte apo nuk ishte identifikuar i pandehuri saktë nga e dëmtuara, shkon në favor të të pandehurit. Por. Duke e pasur parasysh edhe faktin se identifikimi ishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPP, konkretisht nenit 116 par.2 të KPP; që rregullojnë çështjen e identifikimit, gjykata, ka vlerësuar se nuk ka prova që vërtetojnë fajësinë e të pandehurit, për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë.

8. Vendimi për të dëmtuarën

Konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së, e dëmtuara L.Z për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

9.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale, është marrë duke u bazuar nenin 453 paragrafi 1 të KPPRK-së dhe të njëjtat paguhen nga mjetet buxhetore.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr. 273/2016, Datë: 29 prill 2024

Zyrtarja ligjore

Tringë Zogaj

Kryetarja e trupit gjykuese - gjyqtarja,

Fatime Dërmaku

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.